

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 27.10.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vendosur mbi Inicativën për miratimin e qëndrimit parimor, të parashtruar nga Shoqëria për eksploatimin dhe përparimin e granitit dhe mermerit KARIKA DOO P. përmes të autorizuarit Zoran Giçev, avokat nga Sh., nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa e parashtruar nga Shoqëria për eksploatimin dhe përparimin e granitit dhe mermerit KARIKA DOO P. përmes të autorizuarit Zoran Giçev, avokat nga Sh., të evidentuar nën Su-03.nr.400/22, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor, **HIDHET POSHTË.**

A r s y e t i m

Sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 27.10.2022 diskutoi mbi Inicativën për miratimin e qëndrimit parimor Su-03.nr.400/22 të parashtruar nga Shoqëria për eksploatimin dhe përparimin e granitit dhe mermerit KARIKA DOO P. përmes të autorizuarit Zoran Giçev, avokat nga Sh..

Në Inicativën parashtruesi propozon që Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë qëndrim parimor lidhur me nenin 39 paragrafi (2) të Ligjit për lëndë të para minerale (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.136/12, 25/13, 93/13, 44/14, 160/14, 129/15 dhe 195/12), dhe për shkak të zbatimit gabueshëm të kësaj dispozite nga organet e administratës, Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative.

Sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje me rëndësi për sigurimin unik në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajsh dhe jo më shumë se gjashtë muaj me iniciativë të tyre ose me iniciativë të kryetarit të gjykatës ose me iniciativë të seancave të gjyqtarëve ose sektorëve gjyqësorë të gjykatave ose me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në web faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vepruar mbi Iniciativën konsideron se e njëjta është parashtruar nga një person juridik përmes të autorizuarit – avokatit, e jo nga subjekti që sipas dispozitës të sipërcituar është i autorizuar për këtë.

Duke marrë parasysh të ekspozuarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron se iniciativa Su-03.nr.400/22 duhet të hidhet poshtë për arsye që nuk është parashtruar nga subjekti i autorizuar, sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat.

Gjykata Supreme
E Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme